



**BASHKIA TIRANË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 70, datë 7.10.2016

**Për**

**“MIRATIMIN PËR KALIMIN NË PËRDORIM PA KUNDËRSHPËRBLIM PËR SHOQËRINË “ECO TIRANA SH.A”, TË NJË PASURISË ME NR. 4/165, ME SIPËRFAQE TOTALE 21685.00 M<sup>2</sup> DHE ME EMËRTIMIN “PARKU I TRANSPORTIT TIRANË” DHE ME VENDNDODHJE NË RR.DON BOSKO, TIRANË, NË PRONËSI TË BASHKISË SË TIRANËS, PËR NDËRTIMIN E INFRASTRUKTURËS SË NEVOJSHME PËR USHTRIMIN E FUNSKIONEVE TË SHOQËRISË “ECO TIRANA” SH.A.”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.2, shkronjat “a” dhe “c”, nenit 23, pika 10, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55, pikat 4 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, për “Vetëqeverisjen vendore”; nenit 8 të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 për “Pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar); ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 për “Transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); Kreut IX të Ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar ),; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 378, datë 12.08.1999 për “Kalimin e të drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte pronë publike, organeve të qeverisjes vendore” (i ndryshuar); Vendimi i Këshillit Bashkiak, Tiranë, nr 40, datë 23.05.2016 për “Themelimin dhe pjesëmarrjen e Bashkisë së Tiranës në Shoqërinë aksionare “Eco Tirana” sh.a., miratimin e aktit të themelimit dhe statutit”; Shkresës me nr.prot.28265/1, datë 23.09.2016 nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, si dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Kalimin në përdorim pa kundërshpërblim i pasurisë me emërtimin “Parku i Transportit Tiranë, me nr.pasurie 4/165, ZK 8330, TR-J-8, me vendndodhje në Rr. “Don Bosko, Tiranë”, me sipërfaqe 21685.00 m<sup>2</sup>, lloji i pasurisë “Truall”, Tiranë, në pronësi të Bashkisë së Tiranës për “Eco Tirana” Sh.a, sipas genplanit bashkëlidhur.
2. “Eco Tirana” sh.a, do të përdorë pronën “Parku i Transportit Tiranë” për ushtrimin e funksioneve të saj sipas qëllimit të krijimit dhe objektit të saj të përcaktuar në aktin e themelimit të shoqërisë “Eco Tirana Sh.a.”, kryesisht në funksion të çështjeve logjistike të shoqërisë si krijimi/ndërtimi i selisë së shoqërisë (zyrave të administratës qendrore), qendës së trajnimeve dhe parkut të automjeteve në të cilin do të stacionohet

dhe mirëmbahet flota e mjeteve të pastrimit. Nga e drejta e përdorimit përjashtohen shprehimisht kryerja e aktiviteteve të riciklimit, grumbullimit dhe përpunimit të mbetjeve.

3. Afati i përdorimit të jetë 25 vjet.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen, Kryetari i Bashkisë Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit dhe shoqëria “Eco Tirana” Sh.a”.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 55, të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” dhe pas konfirmimit nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

**K R Y E T A R**

**ALDRIN DALIPI**